



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 190

Tiranë – E enjte, 16 tetor 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 590, datë 15.10.2025	Për përcaktimin e llojeve të tarifave të shërbimeve të ofruara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe të masës së tyre..... 22875
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 591, datë 15.10.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 416, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar 22876
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 592, datë 15.10.2025	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.12.2024, për çështjen “Ramaj kundër Shqipërisë” (për kërkesën nr. 17758/06)..... 22881
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 595, datë 15.10.2025	Për përcaktimin e përbërjes dhe të detyrave të Komitetit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit..... 22881
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 598, datë 15.10.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 969, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij”..... 22883
Udhëzim i ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr. 2, datë 15.10.2025	Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive..... 22884

**VENDIM****Nr. 590, datë 15.10.2025****PËR PËRCAKTIMIN E LLOJEVE TË
TARIFAVE TË SHËRBIMEVE TË
OFRUARA NGA AGJENCIA KOMBËTARE
E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT
DHE TË MASËS SË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 36, të ligjit nr. 43/2023, “Për qeverisjen elektronike”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shërbimet elektronike, në favor të organeve dhe të institucioneve të administratës publike, subjekteve private dhe qytetarëve, ofrohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, kundrejt aplikimit të tarifave përkatëse.

2. Për organet dhe institucionet e administratës publike, shërbimet elektronike për nënshkrim elektronik, vulë elektronike, certifikatë elektronike për projektin e fiskalizimit, vulë kohore, transaksion në platformën qeveritare të ndërveprimit (GG) ofrohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, me tarifën zero lek.

3. Për subjektet private, shërbimet elektronike për nënshkrim elektronik, vulë elektronike, certifikatë elektronike për projektin e fiskalizimit, transaksion në platformën qeveritare të ndërveprimit (GG) ofrohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me tarifë, si më poshtë vijon:

a) 4 800 (katër mijë e tetëqind) lekë, përfshirë TVSH-në, për nënshkrimin elektronik, me afat vlefshmërie 1 (një) vit;

b) 20 (njëzet) lekë, përfshirë TVSH-në, për shërbimin e vulosjes së dokumenteve me vulë elektronike/për transaksion;

c) 4 000 (katër mijë) lekë, përfshirë TVSH-në, për certifikatë elektronike për projektin e fiskalizimit, me afat vlefshmërie 1 (një) vit;

ç) 15 (pesëmbëdhjetë) lekë, përfshirë TVSH-në, për transaksion në platformën qeveritare të ndërveprimit (GG).

4. Për shtetasit shqiptarë dhe shtetasit e huaj, shërbimi i nënshkrimit elektronik ofrohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit,

me tarifën 2 000 (dy mijë) lekë, me afat vlefshmërie 1 (një) vit.

5. Për nëpunësit e administratës në institucionet publike me vetëfinancim, shërbimi i nënshkrimit elektronik ofrohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, me tarifën 4 800 (katër mijë e tetëqind) lekë, me afat vlefshmërie 1 (një) vit.

6. Pagesa e tarifave të përcaktuara në këtë vendim kryhet në momentin e aplikimit *on-line* për kryerjen e veprimeve dhe të procedurave, nëpërmjet pagesës elektronike në portalin qeveritar “e-Albania”.

7. Pagesat e tarifave, të përcaktuara në shkronjat “a” e “c”, të pikës 3, dhe të pikave 4 e 5, të këtij vendimi, realizohen në marrje të çdo shërbimi elektronik.

8. Pagesat e tarifave, të përcaktuara në shkronjat “b” e “ç”, të pikës 3, të këtij vendimi, realizohen periodikisht çdo muaj për numrin e transaksioneve të kryera gjatë asaj periudhe *on-line* nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, si dhe kryerja e tyre shihet në kohë reale.

9. Të ardhurat e realizuara derdhen 100% në buxhetin e shtetit, në përputhje me vendimin nr. 432, datë 28.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijohen nga institucionet buxhetore”.

10. Vendimi nr. 35, datë 22.1.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për shërbimet elektronike të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, shfuqizohet.

11. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



VENDIM

Nr. 591, datë 15.10.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 416, DATË 11.7.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË ELBASAN, TË QARKUT TË ELBASANIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 37, të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 416, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar, të dhënat e pronave, me numra rendorë 246 dhe 271, zëvendësohen me të dhënat sipas formularëve dhe planeve të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Bashkia Elbasan dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Bashkia Elbasan						Identifikoi pronën		Gentiana Kerri (Ing.Gjeodet Dr.Pronave Publike dhe Shtetit) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)					
						Supervizoi:		Valbona Lufta (Arkitekte Dr. Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)					
						Aprovoi:		Gledian Llatja (Kryetari i Bashkisë Elbasan) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)					
Nr.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronë/pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me datë	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)	
						Truall (m2)	Ndërtesë (m2)						
246	8524 EL; M-8	13/92	Truall+Ndërtesë	Shtëpia muze "Lef Nosi"	545.3	545.3	156	Kulturë dhe histori	Bashkia Elbasan	Bashkia Elbasan	VKM Nr. 416 datë 11.07.2007	Ndërtesë 2 Kat Bodrum 156 m2 Kati perdehe 156 m2 Kati parë 136 m2	
	8524 EL; M-8	13/93	Truall+Ndërtesë	Shtëpia muze "Lef Nosi"	63.9	63.9	63.9	Kulturë dhe histori	Bashkia Elbasan	Bashkia Elbasan		Ndërtesë 1 Kat	

Shënim: Sipërfaqja totale do të plotësohet vetëm për prona me shumë komponentë (që përbëhen nga disa pasuri).



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI :SHTET

DATE 02.07.2025

QELLIMI: "Perditesim"

VENDNDODHJA

BASHKIA ELBASAN , L.KALA

DVASHK/ZVASHK ELBASAN

ZONA KADASTRALE 8524

NUMRI PASUR 13/92

INDEX HARTE EL;(M-8)

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE "Truall"

SIP.TRUALL =545.3m2


SIPERFAQE GJURMES SE NDERTIMIT = 0 m2

NUMRI KATEVE_

NUMRI PEMEVE_

X=506743.990
Y=4553334.957

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=506841.490
Y=4553334.957X=506743.990
Y=4553270.457

SH 1:500

X=506841.490
Y=4553270.457

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			V-PAS. 13/175-nd, 13/182		
2	JUGE			J-PAS. 13/321		"SHTEPJA MUZE E LEF NOSIT "
3	LINDJE			L-PAS. 13/91		
4	PERENDIM			P-PAS. 13/93 ,13/94		

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
QLEDIAN LLATJA

REALIZOI PER BASHKINE ELBASAN

GRUPI I PUNES
ASHK Ing. MENTOR TOLA
Ark. VALBONA LUFTA
Ing. GENTIANA KERRI

MIRATOI PER ASHK
DREJTORI DVASHK
BRIXHIDA BIÇAKU

NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PLANVENDOSJA ESHTË PERGATITUR PER PASURINE 13/92 E LLOJIT TRUALL ME S=545.3 m2 SHTEPJA MUZE "LEF NOSI" ESHTË POZICIONUAR SIPAS FAKTIT OBJEKTIT SHTEPISE MUZE "LEF NOSI" ME SIPERFAQE TE GJURMES SE NDERTIMIT S=156 m2 2kat +bodrum, BODRUMI SIPERFAQE =156m2 KATI PERDHE SIPERFAQE =156m2 KATI I PARE SIPERFAQE =136m2 FIGURON PASURI SHTET DHE DO KALOJE NE PRONESI TE BASHKISE ELBASAN.

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI "SHTEPJA E LEF NOSIT "

NENSHKRIMI

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE																																								
PRONARI :SHTET		DATE 02.07.2025		QELLIMI: "Perditesim"																																				
VENDNDODHJA BASHKIA ELBASAN , L.KALA DVASHK/ZVASHK ELBASAN ZONA KADASTRALE 8524 NUMRI PASUR 13/93 INDEX HARTE EL:(M-8)																																								
TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE "Truall" SIP.TRUALL =63.9m2 SIPERFAQE GJURMES SE NDERTIMIT = 0 m2 NUMRI KATEVE_ NUMRI PEMEVE_																																								
X=506743.990 Y=4553334.957		KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE		X=506841.490 Y=4553334.957																																				
X=506743.990 Y=4553270.457		SH 1:500		X=506841.490 Y=4553270.457																																				
SHPJEGUES NDERTESE 1k. SIPERFAQE TRUALL =63.9m2 SIPERFAQE NDERTESE =63.9m2																																								
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 5%;">Nr.</th> <th style="width: 15%;">ORIENTIMI</th> <th style="width: 15%;">PERDORIMI</th> <th style="width: 15%;">TIPI KUFIRIT</th> <th style="width: 15%;">KUFITARI</th> <th style="width: 15%;">ID/NIPT</th> <th style="width: 30%;">SHENIME TE REALIZUESIT</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>VERI</td> <td></td> <td></td> <td>V-PAS. 13/94</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>JUGE</td> <td></td> <td></td> <td>J-PAS. 13/321</td> <td></td> <td>PASURIA 13/93 ME PRONAR SHTET.</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>LINDJE</td> <td></td> <td></td> <td>L-PAS. 13/92</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>PERENDIM</td> <td></td> <td></td> <td>P-PAS. 13/333</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT	1	VERI			V-PAS. 13/94			2	JUGE			J-PAS. 13/321		PASURIA 13/93 ME PRONAR SHTET.	3	LINDJE			L-PAS. 13/92			4	PERENDIM			P-PAS. 13/333		
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT																																		
1	VERI			V-PAS. 13/94																																				
2	JUGE			J-PAS. 13/321		PASURIA 13/93 ME PRONAR SHTET.																																		
3	LINDJE			L-PAS. 13/92																																				
4	PERENDIM			P-PAS. 13/333																																				
MIRATOI KRYETARI I BASHKISE GLEDIAN LLATJA REALIZOI PER BASHKINE ELBASAN GRUPI I PUNES ASHK Ing. MENTOR TOLA Ark. VALBONA LUFTA Ing. GENTIANA KERRI MIRATOI PER ASHK DREJTORI DVASHK BRIXHIDA BIÇAKU NENSHKRIMI / VULA _____			TEKNOLOGJIA E MATJEVE: _____ Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _____ Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: PASURIA ME NR. 13/93 E LLOJIT TRUALL ESHTË OBJEKT NJE KAT ME SIPERFAQE 63.9m2. FIGURON SHTET DHE DO KALOJE NE PRONESI TE BASHKISE ELBASAN. <u>PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET</u> EMRI_ NUMRI PASURISE 13/93 ME PRONAR SHTET. NENSHKRIMI _____																																					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale																																								



1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Bashkia Elbasan		Identifikoi pronën		Gentiana Kerri (Ing.Gjeodet Dr.Pronave Publike dhe Strehimit) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)									
		Supervizori:		Valbona Lufta (Arkitekte Dr. Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)									
		Aprovoni:		Gledian Llatja (Kryetari i Bashkisë Elbasan) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vuja)									
Nr.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronë/ pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/ pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)	
						Truall (m2)	Ndërtesë (m2)						
271	8524 EL- L-8	12/15	Truall	Shtëpia muze "Aleksandër Xhuvani"	216.5	216.5		Kulturë dhe Histori	Bashkia Elbasan	Bashkia Elbasan	VKM Nr. 416 datë 11.07.2007		
	8524 EL- L-8	12/153	Truall+Ndërtesë	Shtëpia muze "Aleksandër Xhuvani"	401.5	401.5	187.3	Kulturë dhe Histori	Bashkia Elbasan	Bashkia Elbasan	VKM Nr. 416 datë 11.07.2007	Ndërtesë 1 kat 187.3 m2 Bodrum 140 m2	

Shënim: Sipërfaqja totale do të plotësohet vetëm për pronë me shumë komponentë (që përbëhen nga disa pasuri).



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI :SHTET

DATE 02.07.2025

QELLIMI: "Perditesim"

VENDNDODHJA

BASHKIA ELBASAN , L.KALA

DVASHK/ZVASHK ELBASAN

ZONA KADASTRALE 8524

NUMRI PASURISE 12/15

INDEX HARTE EL;(L-8)

TE DHENAT E PASURISE

SIP. E PAS. 12/15 = 216.5m2

LLOJI PASURISE "Trueall"

SIP. E PAS. 12/153 = 401.5m²
SIP. TOTALE E PASURIVE = 618m²

SUPERFAOE GIURMES SE NDERTIMIT = 0 m2

NUMRI KATEVE


NUMRI PEMEVE

X=506767 619

$$Y=4553505.380$$

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

Y-506865 119

$$Y=4553505.380$$
 $X=506767.619$
$$Y=4553440.880$$

SH 1:500

X=506865.119

$$Y=4553440.880$$

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			PAS nr.12/1		
2	JUGE			PAS nr.12/50		SHTEPIA MUZE "ALEKSANDER XHUVANI"
3	LINDJE			PAS nr.12/68, 12/24		
4	PERENDIM			PAS nr.12/14 ,12/152		


MIRATOJ
KRYETARI I BASHKISE
OLENDRA LLATJAJ

REALIZOJ PER BASHKINE ELBASAN
GRUPI I PUNES
ASHK Ing. MENTOR TOLA
Ark. VALBONA LUFTA
Ing. GENTIANA KERRI

MIRATOJ PER ASHK
DREJTORI DVASHK
BRIXHIDA BIÇAKU
NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTI MI KUFIRIT:

Kode per percaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

ESHTË POZICIONUAR SIPAS FAKTIT SHTEPIA MUZE "ALEKSANDER XHUVANI" E CILA FIGURON PASURIT SHETËT DHE DO KALOJE NE PRONESI TE BASHKISE ELBASAN.
KJO PASURI NDODHET NE Z.K. 8524 , INDEX HARTE EL;(L)-8 , NUMRI PASURISE 12/153 ,12/15
SIP.TRUALLI = 618m2 SIPERFAQE GJURMES NDOTIMT=187.3 m2 Ndertese 1 kat , Podrum 140m2

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI SHTET(SHTEPIA MUZE "ALEKSANDER XHUVANI")

NENSHKRIMI

Kode per teknologji e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitar të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Marta Kadastrale

**VENDIM****Nr. 592, datë 15.10.2025****PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT, DATË 10.12.2024,
PËR ÇËSHTJEN “RAMAJ KUNDËR
SHQIPËRISË” (PËR KËRKESËN
NR. 17758/06)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.12.2024, për çështjen “Ramaj kundër Shqipërisë”, për kërkesën nr. 17758/06, përfundimtar në datën 28.4.2025, në shumën 4 000 (katër mijë) euro, në lidhje me dëmin jopasuror, dhe shumën 10 000 (dhjetë mijë) euro, në lidhje me kostot e shpenzimit, plus çdo taksë, që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës, ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkuesit Eduart Ramaj, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.12.2024, për çështjen “Ramaj kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 17758/06.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3 të këtij vendimi, në favor të kërkuesit, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afati 3-mujor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marginal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit plus 3%.

6. Efektet financiare të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2025.

7. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 595, datë 15.10.2025****PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES DHE
TË DETYRAVE TË KOMITETIT
KOMBËTAR TË KËRKIM-SHPËTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4/1, të ligjit nr. 10435, datë 23.6.2011, “Për shërbimin e kërkim-shpëtimit (SAR) në Republikën e Shqipërisë në rast aksidentesh ajrore dhe detare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e përbërjes dhe të detyrave të Komitetit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit (në vijim “Komiteti”).

2. Komiteti kryesohet nga Koordinatori Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- a) komandantin e Forcës Ajrore;
- b) komandantin e Forcës Detare;
- c) komandantin e Forcës Tokësore;
- ç) kryetarin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit;

d) një përfaqësues të nivelit të lartë nga Ministria e Punëve të Brendshme;

dh) një përfaqësues të nivelit të lartë drejtues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

e) një përfaqësues të nivelit të lartë drejtues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;



ë) një përfaqësues të nivelit të lartë drejtues nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;

f) drejtorin e përgjithshëm të Albcontrol-it;

g) zëvendës drejtorin e përgjithshëm të Doganave dhe një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me funksion menaxherial dhe teknik të fushës në Departamentin Operativo-Hetimor;

g) drejtorin e përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit;

h) drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;

i) drejtorin e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore;

j) drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit;

k) drejtorin ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil;

l) drejtorin e përgjithshëm të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;

ll) drejtorin e përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil;

m) drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare;

n) drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;

n) Sekretarin e Përgjithshëm të Kryqit të Kuq Shqiptar.

3. Komiteti kryen këto detyra:

a) planifikon dhe zhvillon politika kombëtare në fushën e kërkim-shpëtimit;

b) harton politika dhe strategji në fushën e kërkim-shpëtimit;

c) rishikon politikat dhe strategjitë në fushën e kërkim-shpëtimit;

ç) bashkëpunon me autoritetet dhe organizatat civile apo ushtarake për zhvillimin me efektivitet të politikave e të strategjive të shërbimit të kërkim-shpëtimit (SAR);

d) monitoron zbatimin e politikave e të strategjive, me qëllim rritjen e efektivitetit të përgjithshëm dhe efikasitetin e shërbimeve SAR;

dh) promovon politikat dhe programet e sigurisë për të ndihmuar qytetarët të shmangin ose të përballen me situatat në rastet e aksidenteve ajrore e detare;

e) zhvillon kërkimet për planet, politikat, manualët, kërkesat dhe standardet e kërkim-shpëtimit;

ë) orienton politika për trajnimin dhe aftësimin e personelit të përfshirë në operacionet e kërkim-shpëtimit;

f) bashkëpunon me organizata dhe agjenci ndërkombëtare për zhvillimin e politikave dhe aktiviteteve të përbashkëta në fushën e kërkim-shpëtimit.

4. Me qëllim përmbushjen e detyrave, të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, kryetari i Komitetit cakton mbledhjet e rregullta periodike, jo më pak se 2 (dy) herë në vit dhe të jashtëzakonshme, sipas rastit në ngjarje madhore, në rast operacionesh masive për aksidentet ajrore e detare.

5. Me miratimin e anëtarëve të Komitetit, sipas nevojës, në mbledhjet e Komitetit ftohen ekspertë të fushës për të dhënë kontributin e tyre në situata të veçanta.

6. Sekretar teknik i Komitetit caktohet një përfaqësues nga Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimit.

7. Sekretari teknik i Komitetit kryen këto detyra:

a) siguron organizimin dhe funksionimin efikas të Komitetit;

b) siguron mbështetjen teknike për zhvillimin e takimeve dhe të proceseve të lidhura me funksionimin e Komitetit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit;

c) siguron përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve të agjendës përkatëse për mbledhjen e Komitetit, 5 (pesë) ditë pune përpara takimit;

ç) bashkërendon veprimtarinë midis agjencive dhe institucioneve të përfshira në Komitet;

d) përditëson situatën dhe siguron informacion të saktë për operacionet e kërkim-shpëtimit;

dh) bën dokumentimin e aktivitetit dhe të takimeve të Komitetit.

8. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes dhe Komiteti Kombëtar i Kërkim-Shpëtimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 598, datë 15.10.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 969, DATË 2.12.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE E TË
PROCEDURAVE TË ZGJEDHJES SË
ANËTARËVE TË KËSHILLIT
KOMBËTAR TË RINISË, SI DHE TË
MËNYRËS SË ORGANIZIMIT E TË
FUNKSIONIMIT TË TIJ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 969, datë 2.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave të zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Rinisë, si dhe të mënyrës së organizimit e të funksionimit të tij”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në titull, pas fjalëve “... procedurave të zgjedhjes ...” shtohen “... si dhe kompensimit të shpenzimeve ...”;

b) Në pikën 1, pas fjalëve “... procedurat e zgjedhjes ...” shtohen “... si dhe kompensimit të shpenzimeve ...”;

c) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. KKR-ja përbëhet nga 18 (tetëmbëdhjetë) anëtarë, nga të cilët, jo më pak se 6 (gjashtë) i përkasin secilës gjini. Anëtarët e KKR-së janë, si më poshtë vijon:

a) ministri përgjegjës për rininë, bashkëkryetar;

b) titullari i Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR);

c) 1 (një) përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;

ç) 4 (katër) përfaqësues nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë;

d) 4 (katër) përfaqësues të këshillave studentorë;

dh) 2 (dy) përfaqësues të parlamentit të nxënësve;

e) 2 (dy) përfaqësues nga komuniteti shqiptar në diasporë;

ë) 1 (një) përfaqësues nga pakicat kombëtare rome ose egjiptiane;

f) 1 (një) përfaqësues nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara;

g) 1 (një) përfaqësues nga komuniteti LGBTI+.”;

ç) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Bashkëkryetari i KKR-së zgjidhet nëpërmjet votimit nga anëtarët jopërfaqësues të institucioneve shtetërore, në mbledhjen e parë të KKR-së.”;

d) Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Kandidati për anëtar i KKR-së duhet të jetë shtetas shqiptar dhe t’i përkasë grup-moshës rinore, të përcaktuar në shkronjën “f”, të nenit 3, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, të ndryshuar.”;

dh) Pas shkronjës “c”, të pikës 8, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) të jetë në detyrë pranë strukturës së përfaqësuar gjatë periudhës së thirrjes dhe votimit të kandidatëve, për kandidatin e përmendur në shkronjat “d” dhe “dh”, të pikës 2, të këtij vendimi.”;

e) Në shkronjën “b”, të pikës 9, pas nënndarjes “vi” shtohen nënndarjet “vii”, “viii”, “ix” e “x”, me këtë përmbajtje:

“vii. letër mbështetjeje e lëshuar nga një shoqatë shqiptare në diasporë për rastin e kandidatit të përmendur në shkronjën “e”, të pikës 2, të këtij vendimi;

viii. letër mbështetjeje e lëshuar nga një organizatë jofitimprurëse, që në statutin e saj ka të përcaktuar si objekt të veprimtarisë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pakicës kombëtare përkatëse, për rastin e kandidatit të përmendur në shkronjën “e”, të pikës 2, të këtij vendimi;

ix. letër mbështetjeje e lëshuar nga një organizatë jofitimprurëse, që në statutin e saj ka të përcaktuar si objekt të veprimtarisë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, për rastin e kandidatit të përmendur në shkronjën “f”, të pikës 2, të këtij vendimi;

x. letër mbështetjeje e lëshuar nga një organizatë jofitimprurëse, që në statutin e saj ka të përcaktuar si objekt të veprimtarisë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave LGBTI+, për rastin e kandidatit të përmendur në shkronjën “g”, të pikës 2, të këtij vendimi.”;

ë) Në pikën 10, fjalët “... e përmendur në shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 2, të këtij vendimi ...” zëvendësohen me “... jopërfaqësues të institucioneve shtetërore ...” dhe pas fjalëve “...



votimi përzgjedhës ...” shtohen “... për kandidatët e përmendur në shkronjat “ç”, “d” e “dh”, të pikës 2, të këtij vendimi ...”;

f) Pas pikës 10 shtohen pikat 10/1, 10/2 e 10/3, me këtë përmbajtje:

“10/1. Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve të përmendur në shkronjat “e”, “ë”, “f” e “g”, të pikës 2, të këtij vendimi, bëhet nga një komision vlerësimi, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të emëruar nga ministri përgjegjës për rininë, të përzgjedhur, si më poshtë vijon:

a) 1 (një) anëtar i caktuar nga ministri përgjegjës për rininë, në rolin e kryetarit të komisionit;

b) 1 (një) anëtar i caktuar nga titullari i Agjencisë Kombëtare për Rininë (AKR);

c) 1 (një) anëtar në detyrë i KKR-së, përfaqësues i të rinjve, që nuk rikandidon në thirrje.

10/2. Vlerësimi maksimal për dokumentacionin e kandidatëve të përmendur në shkronjat “e”, “ë”, “f” e “g”, të pikës 2, të këtij vendimi, është 40 (dyzet) pikë dhe përcaktohet, si më poshtë vijon:

a) Propozimi i një politike rinore vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë;

b) Jetëshkrimi vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë;

c) Angazhimi në çështjet e rinisë vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë;

ç) Angazhimi në çështjet e komunitetit që përfaqëson vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë.

10/3. Ministria përgjegjëse për rininë dhe Agjencia Kombëtare për Rininë bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme dhe ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale për promovimin e thirrjes për kandidim në KKR dhe për verifikimin e dokumentacionit të kandidatëve, kur është e nevojshme.”;

g) Në pikën 19, fjala “anëtarët” zëvendësohet me “anëtarin”;

gj) Pas pikës 19 shtohen pikat 19/1 e 19/2, me këtë përmbajtje:

“19/1. Anëtari i KKR-së nuk shpërblehet për kontributin e dhënë në KKR. Shpenzimet e bëra në kuadër të veprimtarisë së KKR-së mbulohen nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR).

19/2. Anëtarit të KKR-së, jopërfaqësues të institucioneve shtetërore, që merr pjesë në mbledhjen e KKR-së, i mbulohen shpenzimet e mëposhtme:

a) dietë ditore në masën 500 (pesëqind) lekë, në rastin kur banon në një largësi prej 50–100 km nga vendi i organizimit të mbledhjes;

b) dietë ditore në masën 1000 (një mijë) lekë, në rastin kur banon në një largësi mbi 100 km nga vendi i organizimit të mbledhjes;

c) shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR), kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, e miratuar në vendimin nr. 92, datë 21.2.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave të transportit rrugor ndërqytetës të udhëtarëve me autobus”.”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për rininë, ministria përgjegjëse për arsimin, ministria përgjegjëse për punët e jashtme, ministria përgjegjëse për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 2, datë 15.10.2025

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURËN E SHPALLJES SË ZONËS PRIORITARE TË ZHVILLIMIT NË TERRITORET E BASHKIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025, “Për paketën e maleve”,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës me përparësi zhvillimin e ekonomisë malore (në vijim, zonë zhvillimi) nga të gjitha bashkitë në vend, sipas ndarjes territoriale në fuqi.



2. Bashkitë kryejnë procedurat në përputhje me parashikimet ligjore të legjislationit, që rregullon organizimin e funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe ato të parashikuara në këtë udhëzim.

3. Bashkitë veprojnë dhe udhëhiqen nga parimi i informimit, i konsultimit, i transparencës dhe i eficiencës.

II. PROCEDURAT E IDENTIFIKIMIT TË ZONËS SË ZHVILLIMIT

1. Kryetari i bashkisë cakton nëpunësit ose strukturën përgjegjëse për:

a) identifikimin dhe hartëzimin e zonës së zhvillimit brenda territorit të bashkisë, në përputhje me parashikimet e shkronjës “ç”, të nenit 3, të ligjit nr. 20/2025, “Për paketën e maleve”;

b) mbledhjen dhe administrimin e kërkesave për shprehje paraprake interesi nga subjekte të ndryshme të paraqitura në platformën digjitale të dedikuar për zbatimin e ligjit nr. 20/2025, “Për paketën e maleve”;

c) bashkërendimin e bashkëpunimin me drejtorinë përkatëse vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për të marrë informacion të përgjithshëm mbi gjendjen juridike të pronësisë së pasurive, që gjenden në projektpropozimin paraprak për zonën e zhvillimit. Për efekt të kësaj shkronje, me “informacion të përgjithshëm” kuptohen të dhënat për numrin total të pasurive shtetërore dhe sipërfaqen e përgjithshme të tyre, përkundrejt numrit dhe sipërfaqeve të pasurive në pronësi private, në mënyrë që të evidentohen raporti i tyre dhe vështirësitë në dhënien e akteve të zhvillimit të territorit të përmendura në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 20/2025. Agjencia Shtetërore e Kadastrës i përgjigjet kërkesës së paraqitur të bashkisë përkatëse jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e marrjes së kërkesës për informacion;

ç) hartimin e kërkesës për shpalljen e zonës së zhvillimit dhe të relacionit shoqërues.

2. Relacioni shoqërues, sipas shkronjës “ç”, të pikës 1, të këtij kreu, përmban analizë, për:

a) nevojën e shpalljes së zonës së zhvillimit dhe për potencialet, që nxit kjo nismë (për shembull, potencialin për zhvillimin ekonomik, industrial apo turistik të zonës);

b) praninë e poseduesve jopronarë në territorin e zonës;

c) vështirësitë e hasura në dhënien e akteve të zhvillimit të territorit (leje zhvillimi dhe ndërtimi) në

raport me pjesën tjetër të territorit, si pasojë e mosrregullimit të marrëdhënieve juridike të pronësisë private mbi tokën.

3. Nëpunësit ose struktura përgjegjëse e zhvillojnë veprimtarinë brenda afatit të përcaktuar nga kryetari i bashkisë.

4. Nëpunësit ose struktura përgjegjëse, në përfundim të analizës tërësore të të dhënave dhe dokumentacionit, mund të propozojnë shpalljen e një ose disa zonave, brenda territorit të bashkisë, si zona zhvillimi. Dosja e përgatitur i paraqitet kryetarit të bashkisë dhe përmban këto dokumente:

a) Kërkesën për shpalljen e zonës së zhvillimit;

b) Relacionin shoqërues, hartuar në përputhje me parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij kreu, që evidenton përmbushjen e të gjitha detyrave të nëpunësve ose të strukturës përgjegjëse;

c) Hartën e zonës së propozuar, sipas sistemit KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto (manual e digjital);

ç) Listën e aktiviteteve të mundshme/të synuara për zhvillim, bazuar në sektorët me prioritet;

d) Të dhëna për praninë e poseduesve jopronarë brenda zonës së propozuar.

III. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË PROPOZIMIT PËR SHPALLJE TË ZONËS SË ZHVILLIMIT NGA MINISTRI PËRGJEGJËS PËR PUSHTETIN VENDOR

1. Pas përfundimit të procedurës së parashikuar në kreun II të këtij udhëzimi, kryetari i bashkisë paraqet pranë ministrit përgjegjës për pushtetin vendor kërkesën për shpalljen e zonës zhvillimore në territorin e bashkisë. Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

a) Raporti përmbledhës për procedurën e ndjekur nga bashkia përkundrejt parashikimeve të këtij udhëzimi;

b) Harta e zonës së propozuar dhe, nëse propozohet shpallja e më shumë se një zone (për shembull, territor i bashkisë ose pjesë malore e atij territorit), harta që pasqyron vendndodhjen e çdo zone brenda territorit të bashkisë;

c) Relacioni shoqërues.

Në këtë dokumentacion shoqërues të kërkesës duhet të renditet gjithashtu:

i. niveli i pranisë së poseduesve jopronarë;

ii. vështirësitë e hasura në dhënien e akteve të zhvillimit të territorit (leje zhvillimi dhe ndërtimi) në raport me pjesën tjetër të territorit, si pasojë e mosrregullimit të marrëdhënieve juridike të



pronësisë private mbi tokën. Duhet të evidentohet niveli i akteve të zhvillimit të territorit në këtë zonë përkundrejt zonave të tjera dhe se si mosrregullimi i marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi tokën ka ndikuar në këtë zonë.

2. Ministri përgjegjës për pushtetin vendor, pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, mund të kërkojë sqarime në lidhje me dokumentacionin apo plotësim të dokumentacionit të përmendur në pikën 1 të këtij kreu. Njoftimi për plotësimin e dokumentacionit ose paraqitjen e dokumentacionit shtesë i përcillet kryetarit të bashkisë me shkresë zyrtare. Mosparaqitja e dokumentacionit plotësues ose e dokumentacionit shtesë në përfundim të afatit 10-ditor nuk pezullon procesin e vlerësimit të kërkesës. Në këtë rast, vlerësimi i kërkesës bëhet mbi dokumentacionin e dosjes së administruar.

3. Në përfundim të vlerësimit të kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues, nëse konstatohet se bashkia ka përmbushur kriteret ligjore sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, ministri përgjegjës vendos t'i propozojë Këshillit të Ministrave shpalljen e territorit të bashkisë apo të pjesës malore të atij territori si zonë zhvillimi.

4. Kërkesa e bashkisë kompetente për shpalljen e zonës së zhvillimit, që nuk përmbush kriteret ligjore dhe ato të parashikuara në këtë udhëzim, në lidhje me dokumentacionin që duhet të paraqitet e procedurën që duhet ndjekur, refuzohet. Vendimi i ministrit përgjegjës për refuzimin e kërkesës përmban arsyet e refuzimit.

5. Bashkia mund të iniciojë sërish procesin e identifikimit e të vlerësimit të zonës së zhvillimit, në përputhje me parashikimet e këtij udhëzimi, për atë zonë apo ndonjë zonë tjetër brenda territorit.

6. Bashkia publikon në faqen zyrtare të internetit vendimin e Këshillit të Ministrave për shpalljen e zonës së zhvillimit, si dhe të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me procedurat përkatëse. Bashkia siguron informacionin e nevojshëm, që do të vendoset në platformën digjitale të dedikuar për zbatimin e ligjit nr. 20/2025, “Për paketën e

maleve”, në lidhje me ecurinë e zbatimit të ligjit në bashkinë përkatëse.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore shërben si sekretariat teknik për kryerjen e procedurave, sipas kreut III të këtij udhëzimi, dhe, për aq sa është e mundur, mbështet bashkitë lidhur me fuqizimin e kapaciteteve për administrimin e procesit të parashikuar në këtë udhëzim.

2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës bashkëpunon e ndërvepron, në përputhje me afatet e parashikuara në këtë udhëzim, me qëllim përshpejtimin e procesit të identifikimit të zonës së zhvillimit. Nëpërmjet ndërveprimit me Agjencinë, duhet të synohet të saktësohet që në këtë fazë nëse zona e synuar i është nënshtruar procedurës së regjistrimit fillestar, faza, ku gjendet procedura për atë zonë, si dhe, nëse ka nevojë për përmirësim të regjistrave të pasurisë së paluajtshme, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Bashkia, menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, organizon aktivitete ndërgjegjëse dhe informative në forma të ndryshme, duke përfshirë edhe përdorimin e mjeteve të ndryshme të komunikimit për të rritur nivelin e informimit e të ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi përfitimet nga ky ligj.

4. Udhëzimi nr. 1, datë 19.6.2025, i ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHTETIT PËR
PUSHTETIN VENDOR
Ervin Demo

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 60 lekë

